



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** dhe të nenit 14, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 11, paragrafi 4 i Ligjit nr. 04/L –144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 35/17, dhjetor 2012), dhe të nenit 52, shkronja **h** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 01.12.2016, miratoi këtë

V E N D I M

- I.** Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizik.
- II.** Vendimi i cekur në pikën I, nënkupton këmbimin e:
 1. Pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës, parcela kadastrale nr. 1794-1, Zona kadastrale Prishtinë, Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-01794-1, me
 2. Pronën e paluajtshme në pronësi të Muharrem (Selim) Morina, Selatin (Selim) Morina, Skender (Selim) Morina, pjesën e parcelës kadastrale nr. 1794-3, Zona kadastrale Prishtinë, Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-01794-3.
- III.** Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private.
- IV.** Këmbimi i cekur në pikën II të këtij vendimi, do të publikohet në web-faqen e Komunës dhe tabelën e shpalljeve më të dhënat e pronave të këmbyera, vlerën e tyre, si dhe emrin e pronarit me të cilin është bërë këmbimi.
- V.** Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit.

VI. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhët zyrtare në web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr.046-295915, më 06.12.2016.

KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dipl.